



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.148, datë 15.06.2022

PËR
“CAKTIM TË PËRKOHSHËM”

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 59 pika 1 dhe 4, të ligjit Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në Rregulloren “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve” e ndryshuar, si dhe në relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Zonja Pranvera Gruda, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, të caktohet përkohësisht si prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Shkodër.
2. Zonja Pranvera Gruda, do të ushtrojë funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, nga data 19.06.2022 - 18.09.2022.
3. Të njoftohen për këtë vendim Zonja Pranvera Gruda, Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Shkodër.
4. Gjatë periudhës së caktimit të përkohshëm Zonja Pranvera Gruda do të përfitojë shtesë mbi pagën referuese bazë, në masën 40%.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
6. U shpall në Tiranë, sot më 15.06.2022.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË


KRYETAR
Alfred Balla
Anëtar
Sokol Stojani

ANËTAR
Bujar Shëshi

ZV/KRYETAR
Tartar Bazaj
ANËTAR
Nurihan Seiti



ANËTAR
Elaida Goxhi

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Esmeralda Keshi

ANËTAR
Ludovik Dodaj

ANËTAR
Mirela Bogdani